

RAPORT


I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Master i shkencave në: “Teknologji Informacioni”

Ofruar nga Universiteti Privat “Albanian University”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

**Prof.Dr. Thoma KORINI
Dr. Alketa GREPCKA**



Tetor / 2018

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Msc në "Teknologji Informacioni"

Ofruar nga Universiteti Privat "Albanian University"

	Tabela e të dhënave për programin e studimit	
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	Urdhër Nr.33, datë 31.01.2012
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	VBA Nr. 37, date 19.05.2017
5	Titulli i programit të studimit:	Master i shkencave në "Teknologji Informacioni"
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike
8	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Numri i studentëve për programin e studimit	28

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

HYRJE

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u kontraktua nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) për të bërë vlerësimin e jashtëm periodik të Programit të Studimit Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni" ofruar nga Universiteti Privat "Albanian University". Qëllimi i procesit të vlerësimit të jashtëm është të japë një mendim të pavarur për shkallën në të cilën institucioni në fjalë është i përgatitur dhe i angazhuar të përmbushë me efektivitet dhe përgjegjshmëri kërkesat dhe standardet akademike të diplomave që do të lëshojë. Për të arritur në këtë gjykim, GVJ u mbështet në shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, në dokumentacionin bazë mbi të cilin ngrihet veprimtaria e Universitetit (statuti, rregullorja, etj), dosjen e programit të studimit, regjistrat bazë të përcaktuar nga udhëzimet e Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë (MASR), dokumentacionin e zyrës së burimeve njerëzore, takimet e vizitat e organizuara në institucion etj.

Vlerësimi i programit të studimit u fokusua në analizën e programit, në shqyrtimin e sillabuseve: vendosjen e objektivave të të mësuarit, kompetencat që synohen të fitohen, rrugët nëpërmjet të cilave fitohen (metodat e mësimdhënies), literaturën bazë dhe atë shtesë, mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimin e krediteve, kompetencën e stafit pedagogjik, etj.

Albanian University e ushtron aktivitetin e tij bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe të akteve të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë, Statutin e Universitetit, Rregulloren bazë të tij dhe të akteve të tjera rregullatore të institucionit.

Albanian University fillimisht është hapur si shkollë e lartë universitare jopublike "Ufo Dental" me VKM nr.197, datë 10.04.2004. Me VKM Nr. 597, datë 28.05.2009 Emërtimi dhe emri i shkollës së lartë universitare, private "UFO dental", ndryshon në Universiteti privat "Ufo University.

Dhe me VKM Nr. 603, datë 24.8.2011 ndryshon emërtimi nga "UFO University" në Universiteti Privat "Albanian University".

Albanian University, aktualisht pas riorganizimit të kryer me Urdhër Nr.52, datë 5.02.2016 të MAS, përbëhet nga tre njësi kryesore:

Fakulteti i Shkencave Shoqërore;

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike;

Fakulteti i Shkencave Mjekësore;

Ai ofron programe studimi për të tre ciklet e studimit si dhe realizon kërkim shkencor bazë dhe të aplikuar me anë të njërive përbërëse kryesore, bazë dhe ndihmëse.

Programi i studimit MSc në "Teknologji Informacioni" në Albanian University, është licensuar me urdhër Nr.33, datë 31.01.2012 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Ky program ka për qëllim që nëpërmjet përgatitjes teoriko-praktike të krijojë mundësi studentëve të ushtrojnë profesionin e inxhinierit në fushën e teknologjive të informacionit dhe aplikimeve të tyre dhe ofron bazat e nevojshme për të thelluar studimet më pas në programet e ciklit të tretë në fushën e teknologjisë së informacionit. Ky program studimi i ka kaluar Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në bazë të Urdhërit Nr. 52, datë 05.02.2016.

Në Maj 2017 [Evidencë 126]¹, ky program studimi kaloi akreditimin e parë me kohëzgjatjen prej 1 vit akademik, me afat përfundimi të vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit deri më

¹ Referimi në evidencia bëhet duke dhënë numrin rendor të atribuar në AMS -ASCAL MANAGEMENT SYSTEM (shih listën në aneksin 2)

31.07.2018. Në RVB [Evidencë 2] dhe dokumentacionin mbështetës janë pasqyruar hapat e ndërmarra nga AU në përgjithësi dhe Departamenti i Inxhinierive në veçanti për përmirësimin e elementëve të pasqyruar në Vendimin e Bordit të Akreditimit.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Prof. Thoma KORINI

Dr. Alketa GREPCKA

GVJ është asistuar gjatë gjithë procedurës nga specialistja e ASCAL, Msc. Majlinda Demirmeli.

Universiteti Privat "Albanian University" është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 16.10.2018, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 7/21 Prot, datë 16.10.2018. AU përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 296/2 Prot, datë 18.10.2018 përgjigje në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Nëpërmjet kësaj shkrese Institucioni shpreh dakordësinë me përmbajtjen e këtij Draft Raporti.
Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA BA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit

Vendimi i Bordit të Akreditimit Nr.37, datë 19.05.2017, [Evidencë 126], nuk ka paraqitur në mënyrë eksplicite rekomandime përsa i përket këtij program studimi, por ndërmjet të tjerash ka konstatuar se rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësisimit të kushteve përkundrejt Standardeve Shtetërore "Për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimit të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimit të ciklit të dytë të IAL" dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit është "i përmbush pjesërisht standardet".

Ndër konstatimet që mbështesin këtë vlerësim përmenden:

1. Ngarkesa mësimore e stafit akademik efektiv është e lartë pasi ata angazhohen në disa lëndë në programe të ndryshme, ndërkohë që pjesa më e madhe e stafit të kualifikuar është staf me kontratë;
2. Pedagogët e jashtëm nuk zotërojnë leje individuale nga Institucioni ku janë të punësuar me kohë të plotë, sikurse kërkohet nga Ligji 80/2015;
3. Institucioni është angazhuar në ndërtimin e një laboratorit me aplikime virtuale, por jo mjaftueshëm në ndërtimin e laboratorëve fizik për të afruar studentët drejt aspektit praktik dhe inxhinierik.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për konstatimin 1, institucioni ka përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme situatën duke rekrutuar gjatë vitit akademik 2017-2018 dy pedagogë me gradën shkencore Doktor. Megjithatë ngarkesa mësimore e stafit akademik efektiv vazhdon të mbetet e lartë, por përpjekjet e institucionit vazhdojnë për rekrutimin e personelit akademik efektiv.
- b) Për konstatimin 2, institucioni ka ndërmarrë gjithë hapat e nevojshëm dhe personeli akademik i ftuar zotëron leje individuale nga Institucioni ku është punësuar me kohë të plotë në përputhje me kërkesat e Ligjit 80/2015.

- c) Për konstatimin 3, Departamenti i Inxhinierive ka investuar në paisjen e Laboratorit të Infrastrukturës së Rrjetave [Evidencë 25] duke përmirësuar në këtë mënyrë bazën laboratorike në shërbim të programit të studimit.

Në konkluzion, konstatimet e Bordit të Akreditimit për programin e studimit Master i shkencave në "Teknologji Informativ", duke u trajtuar me prioritet nga AU, janë marrë në konsideratë duke kontribuar në këtë mënyrë në përmbushjen në global të standarteve.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit MSc në Teknologji Informativ

Programi i studimit Master i Shkencave në Teknologji Informativ ka për qëllim të realizojë përgatitjen teoriko-praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit si inxhinier në fushën e teknologjisë së informacionit dhe aplikimeve të saj. Kjo përgatitje, gjatë periudhës dy vjeçare mbi nivelin Bachelor, ku merren bazat e nevojshme për të thelluar studimet dhe për të fituar kompetenca më specifike mbi një problematikë më të profilizuar, u krijon mundësinë studentëve të marrin njohuri më të thelluara në fushën përkatëse. Ky thellim i njohurive ndihmon inxhinierët e rinj në një integrim më të lehtë në tregun e punës.

Të diplomuarit në kuadër të këtij programi studimi do të marrin njohuri teoriko-praktike të nevojshme, me qëllim aftësimin e tyre [Evidencë 127]:

- a) për të zhvilluar veprimtarinë në institucione publike dhe private, ku ka aparaturo të ndryshme, që shërbejnë për përpunimin e informacionit;
- b) për të zhvilluar veprimtarinë në mënyrë të drejtpërdrejtë në firma të ndryshme private të pajisura me sisteme informacioni etj.;
- c) pas një periudhe praktike në profesion dhe studimeve të avancuara, aftësinë për të drejtuar kualifikimin edhe përgatitjen e teknikëve dhe profesionistëve të ardhshëm në këtë fushë.

Kërkimi shkencor në planin strategjik synon [Evidencë 38, faqe 16]:

- Ti krijojë mundësi stafit akademik dhe studentëve për të zhvilluar kërkimin e tyre shkencor.
- Ti shërbejë ngritjes së nivelit të mësimdhënies dhe zhvillimit akademik të brendshëm në Universitet në mënyrë që studentët dhe pedagogët të jenë promovuesit e një kulture nxitëse, bazuar në parimet e të menduarit kritik.
- Të japë kontributin e tij për thellimin e njohurive dhe dijeve njerëzore si edhe aplikimeve të tyre profesionale në vend.
- Të bëjë të mundur një impakt mbi shoqërinë, ekonominë, dhe më tej duke i transferuar njohuritë e zhvilluara më gjerë se sa komuniteti akademik i brendshëm në Universitet.

~~Strategjia afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjate: Në objektivat e strategjisë afatgjatë Albanian~~

University ka si objektiv të zhvillojë, të përkrahë dhe të konsolidojë mësimdhënien dhe kërkimin shkencor si edhe shërbime të tjera në fushën e mësimdhënies, kërkimit shkencor të aplikuar.

Departamenti të Inxhinierive, në kuadër të procesit të Bolonjës synon domosdoshmërinë e lidhjes së drejtpërdrejtë të programeve të diplomave universitare, me praktikën dhe tregun e punës. Për të realizuar këtë objektiv ndjek në mënyrë të vazhdueshme zhvillimet si në rang kombëtar ashtu dhe europian me qëllim përshtatjen sa më të mirë të programeve me kërkesat e tregut të punës.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ²
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Misioni dhe objektivat e këtij programi janë të tilla që mundësojnë hedhjen e bazave shkencore dhe përgatitjen teoriko-praktike të nevojshme për ushtrimin e profesionit si inxhinier në fushën e teknologjisë së informacionit apo në profile të përafërta.</p> <p>Ky program studimi ka për qëllim formimin e të diplomuarve me baza të mira teorike dhe me bagazh të mirë praktik për integrimin në tregun e punës në fushën e Teknologjisë së Informacionit.</p> <p>Programi i studimit MSc në “Teknologji Informacioni” i përgjigjet kërkesave të kohës për rritjen e rolit të teknologjisë së informacionit në gjithë aspektet e jetës së përditshme dhe është në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit. Një studim tregu shoqëruar me pyetsorë drejtuar studentëve dhe bizneseve [Evidencë 44] tregon, ndërmjet të tjerave, për nevojën për specialistë me aftësinë dhe kapacitetin e duhur në fushat që mbulon Departamenti i Inxhinierive.</p> <p>Programi i studimit MSc në “Teknologji Informacioni” kontribon direkt në përgatitjen e specialistëve të cilët me kompetencat e tyre, do të punojnë për zhvillimin e modernizimin e vendit. Në këtë mënyrë, programi i studimit, megjithëse nuk ka të bëjë direkt me fushën e ruajtjes së vlerave kulturore të kombit, mbështet zhvillimet prioritare të kohës në Shqipëri e më gjerë.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Në objektivat e strategjisë afatgjatë Albanian University ka si objektiv të zhvillojë, të përkrahë dhe të konsolidojë mësimdhënien dhe kërkimin shkencor si edhe shërbime të tjera në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p>

² GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

	të aplikuar. Në këtë kuadër programi i studimit MSc në Teknologji Informacioni është përshtatur dhe ecën paralel me strategjinë për zhvillimin e AU.
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi i studimit u përgjigjet kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Gjithashtu, gjykojmë se ato respektojnë standardet dhe kërkesat e Marrëveshjes së Bolonjës dhe reflektojnë zhvillimet dhe kërkesat aktuale e perspektive të tregut të punës në dimensione kombëtare, rajonale e ndërkombëtare. Rishikimi i kurrikulave i ndërmarrë sëfundmi [Evidencë 52] synon përshtatjen më të mirë me kërkesat e tregut si dhe me aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Emërtimi i programit të studimeve MSc “Teknologji Informacioni” është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit (Ligji Nr.10247, datë 4.3.2010, “Për kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”)</p>
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Programet e studimit përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme për tu përshtatur me zhvillimet me të reja në këtë fushë me qëllim që të mbeten atraktive për studentët që synojnë rregjistrimin në këtë program studimi. Kjo përputhet dhe me strategjinë afatgjatë të zhvillimit të AU dhe Departamentit të Inxhinierive [Evidencë 38, Evidencë 39].</p> <p>Referuar takimeve me stafin akademik të programit të studimit MSc në Teknologji Informacioni [Shënime gjatë vizitës], AU synon të përmirësojë punën e tij, përmes aktivizimit të një stafi akademik të kualifikuar dhe punon për aplikimin e metodave bashkëkohore për ta bërë mësimdhënien sa më tërheqëse për studentët, duke synuar kështu një afrim të tyre më të madh drejt studimit me përmirësim të rezultateve të të nxënit.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

Programi i studimit MSc në “Teknologji Informacioni” është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, misionin, objektivat dhe strategjinë e zhvillimit të Albanian University si dhe kërkesat e tregut të punës për specialistë të aftë në fushën e teknologjisë së informacionit.

Standardet e kësaj fushe janë përmbushur.


2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Albanian University, pas riorganizimit të kryer me Urdhër Nr.52, datë 5.02.2016 të MAS, përbëhet nga tre njësi kryesore:

1. Fakulteti i Shkencave Shoqërore;
2. **Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike;**
3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore

AU ofron programe studimi për të tre ciklet e studimit si dhe realizon kërkim shkencor bazë dhe të aplikuar me anë të njësive përbërëse. Programi i studimit MSc në “Teknologji Informacioni” është organizuar nën drejtimin e Departamentit të Inxhinierive, të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike [Evidencë 63, neni 6].

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike përbëhet nga tre Departamente sipas skemës organizative në vijim [Evidencë 65, neni 14, Evidencë 37, faqe 3]:



Organigrama e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike

Fakulteti drejtohet nga Dekani. Sipas Statutit, Dekani i Fakultetit propozohet nga Rektori dhe emërohet nga Senati Akademik mbi bazë të një procesi konkurimi [Evidencë 65, Neni 29].

Senati Akademik përbëhet nga 19 anëtarë, nga të cilët 18 janë përfaqësues të personelit akademik dhe 1 përfaqësues i studentëve [Evidencë 65, Neni 19]. Në Rregulloren e AU përcaktohen raportet e përfaqësimit të personelit akademik nga secili fakultet [Evidencë 43, neni 4, pika 4]. Anëtarët e senatit zgjidhen nga Asambleja e personelit akademik.

Organ kolegjal drejtues i Fakultetit është Dekanati, i cili drejtohet nga Dekani dhe përbëhet nga Dekani, Zv.Dekani, Administrator i Njesisë Kryesore dhe Drejtuesit e departamenteve [Evidencë 37, neni 9]. Organ tjetër kolegjal i Fakultetit është Asambleja e personelit akademik e cila përbëhet nga personeli akademik me kohë të plotë i Fakultetit dhe ka si funksione [Evidencë 37, neni 8]:

- zgjedh anëtarët e personelit akademik, të cilët do të përfaqësojnë njësinë kryesore në Senatin Akademik të AU;
- i propozon Senatit anëtarë nga personeli akademik që do të jenë pjesë në komisionet e përhershme të AU;
- propozon programe të reja studimi ose kërkimi shkencor, hapje, ndryshim ose mbyllje departamentesh ose njësish të tjera;
- shqyrton dhe miraton raportin vjetor të dekanit për veprimtarinë mësimore dhe Kërkimin Shkencor;
- i propozon Senatit Akademik planin strategjik të zhvillimit të fakultetit dhe mbikëqyr realizimin e tij.

Fakulteti në vitin aktual akademik **2017-2018** ka në përbërjen e tij **122** personel akademik efektiv dhe me kontratë. Personel Akademik Efektiv (PAE) janë gjithsej **67** persona, nga të cilët 32 janë me tituj/grada, ndërsa Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë gjithsej **55**, nga të cilët 43 me tituj/grada. (sipas Tabelës nr. 1 në RVB)

Departamenti i Inxhinierive, në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike të AU është njësi bazë e zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore [Evidencë 63, neni 4]. Objektivat Departamentit të Inxhinierive lidhen me objektivat dhe veprimtaritë formuese të programeve të cikleve përkatëse të studimit, të cilat synojnë të arrijnë [Evidencë 63, neni 5]:

- nxitjen dhe koordinimin e aktiviteteve mësimore-kërkimore edhe midis departamenteve, por pa prekur lirinë akademike të personelit akademik;
- bën propozimin për hapjen, riorganizimin ose mbylljen e programeve të studimit që ofron;
- zhvillimin e aktiviteteve kërkimore, konsulta mbi kontrata apo pjesëmarrje në projekte të jashtme kërkimore-shkencore;
- në bashkëpunim edhe me departamente të tjera, harton programet për kurse formimi/programe studimi etj., duke saktësuar mënyrën e mbajtimit të ngarkesës së tyre;
- kryen studimin e tregut të punës dhe në bazë të tij bën propozime për përmirësimin ose/dhe përshtatjen e kurrikulave dhe programeve të studimit që ofron.

Departamenti i Inxhinierive garanton mbarëvajtjen e procesit mësimor në dy ciklet e studimeve [Evidencë 63, neni 6]:

Cikli I:

- Bachelor Inxhinieri Elektronike (180 kredite);

- Bachelor Inxhinieri Kompjuterike (180 kredite);
- Bachelor Teknologji Informacioni (180 kredite);
- Bachelor Inxhinieri Mekatronike (180 kredite);
- Bachelor Inxhinieri Elektrike (180 kredite).

Cikli i II:

- Master i Shkencave Inxhinieri Elektronike (120 kredite);
- Master i Shkencave Inxhinieri Kompjuterike (120 kredite);
- **Master i Shkencave Teknologji Informacioni (120 kredite).**

Departamenti i Inxhinierive në vitin aktual akademik 2017-2018 ka në përbërjen e tij 37 personel akademik efektiv dhe me kontratë. Personel Akademik Efektiv (PAE) janë gjithsej 23 persona, nga të cilët 10 janë me tituj/grada, ndërsa Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë gjithsej 14, nga të cilët 13 me tituj/grada. (sipas Tabelës nr. 1 në RVB)

Riorganizimi dhe struktura aktuale e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike dhe e Departamentit të Inxhinierive ka kontribuar në forcimin e strukturës së Fakultetit duke e përputhur atë me standartet, dhe krijuar mundësitë potenciale në rritjen e peshës së kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit me partnerë si në institucione brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p>	<p>Albanian University, pas riorganizimit të kryer me Urdhër Nr.52, datë 5.02.2016 të MAS, përbëhet nga tre njësi kryesore:</p> <p>Fakulteti i Shkencave Shoqërore; Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike Fakulteti i Shkencave Mjekësore [Evidencë 65].</p> <p>Çdo fakultet ka në përbërjen e tij të paktën tre departamente. Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike ka në përbërjen e tij: Departamentin e Shkencave Ekonomike; Departamentin e Arkitekturës; Departamentin e Inxhinierive [Evidencë 37]. Sipas Statutit të Universitetit, Fakulteti është</p>
<p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>njësi kryesore që bashkërendon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore - kërkimore, të përafërta ose të ndërthurura të njësive bazë [Evidencë 65]. Departamenti i Inxhinierive ka në përbërjen e tij 23 pedagogë efektivë (PAE) nga të cilët 10 me tituj e grada [Evidencë 2].</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për	

realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.

Përgjegjësitë e Departamentit të Inxhinierive si njësi bazë si dhe të stafit të tij janë të përcaktuara qartë në rregulloren e Fakultetit. Departamenti është njësi bazë mësimore-shkencore në Fakultet [Evidencë 37].

Departamenti ka për detyrë të organizojë dhe të administrojë veprimtaritë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor duke respektuar liritë akademike të personelit dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion të tij.

Në përputhje me nevojat për staf akademik Departamenti, paraqet kërkesat të cilat trajtohen sipas një procedure të mirëpërcaktuar e cila menaxhohet nga Zyra e Burimeve njerëzore [Evidencë shtesë 5].

Konkluzionet e vlerësimit:

- 1- Albanian University, pas riorganizimit të kryer me Urdhër Nr.52, datë 5.02.2016 të MAS përbëhet nga tre fakultete. Struktura organizative është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe e ndihmon të realizojë misionin e tij.
- 2- Departamenti i Inxhinierive plotëson kriteret si për personelin akademik në total, ashtu edhe për kërkesat në lidhje me kualifikimin e tij.

Standardet e kësaj fushe janë përmbushur.

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Grupet mësimore të Departamentit të Inxhinierive janë përgjegjëse direkte për mbarëvajtjen e procesit mësimor apo atij kërkimor-shkencor të disiplinave që mbulojnë, për realizimin me cilësi dhe në kohë të planeve dhe programeve mësimore në fuqi.

Departamenti i Inxhinierive është i organizuar në grupe mësimore si vijon [Evidencë 63, neni 8]:

- Grupi mësimor i lëndëve të formimit bazë;
- Grupi mësimor i lëndëve të fushës së Inxhinierisë Mekanike;
- Grupi mësimor i lëndëve të fushës së Inxhinierisë Elektrike;
- Grupi mësimor i lëndëve të fushës së Inxhinierisë Elektronike;
- **Grupi mësimor i lëndëve të fushës së Inxhinierisë Kompjuterike/Teknologjisë së Informacionit.**

Personeli Akademik përbëhet nga pedagogët me kontratë me kohë të plotë (PAE) si dhe personeli akademik i ftuar (PAK). Të drejtat dhe detyrat e tyre përcaktohen në kontratën e punës dhe në rregullore. Personeli Akademik është i angazhuar në mësimdhënie dhe të kërkim shkencor sipas kërkesave dhe standarteve të AU. Personeli akademik mund të angazhohet edhe me punë të tjera të natyrës administrative, në ndihmë të nevojave të Universitetit.

Për vitin akademik 2017-2018 personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është 6 pedagogë gjithsej, nga të cilët 4 janë PAE, të gjithë me tituj/grada dhe 2 PAK, të gjithë me tituj/grada.

Raporti PAE/PAK në këtë program per vitin akademik aktual është 4/2.

Raporti PAE/Totalit të personelit akademik në këtë program per vitin akademik aktual (2017-2018) është $4 / 6 = 67 \%$.

Të dhëna për kualifikimin e stafit akademik:

Referuar të dhënave të RVB [Evidencë 2] si dhe të dhënave të mara gjatë vizitës në Albanian University (e që në mënyrë të detajuar pasqyrohen në anekse), në vijim pasqyrohen të dhëna të përmbledhura që i korrespondojnë vitit akademik 2017-2018.

Viti Akademik	PAE/PAK	Student/PAE	Student/Staf Total
2017-2018	4/2 (2)	28/4 (7st/ 1 PAE)	(4.7 st /1 Pedagog)

Viti Akademik	Ngarkesa mësimore e realizuar			
	PAE në % (orë)	PAK në % (orë)	Nga PAE me tituj e grada në % e totalit	Nga PAK me tituj e grada në % e totalit
2017-2018	74% (521 orë)	26% (186 orë)	100%	100%

Nga sa më sipër, rezulton se numri i studentëve për pedagog në total apo për pedagog efektiv (PAE) është i përshtatshëm për zhvillimin normal të programit të studimit. Nga ana tjetër, vërehet një përmirësim i dukshëm i personelit akademik efektiv me tituj e grada krahasuar me vitet e mëparshme. Gjithashtu, duke ju referuar edhe të dhënave të viteve të mëparshme, vërehet një përmirësim i raportit personeli akademik efektiv/personeli akademik me kontratë.

Në këtë mënyrë për vitin akademik 2017-2018, personeli akademik me kontratë i angazhuar në këtë program studimi është sa gjysma e atij efektiv, ndërsa ngarkesa që ai përballon përbën rreth 26% të totalit të ngarkesës. Kjo ul shkallën e ekspozimit ndaj riskut të disponibilitetit të personelit akademik me kontratë (që mund të vijë për efekt të pengesave, vonesave apo edhe mungesës së vullnetit të institucioneve të tjera të arsimit të lartë në të cilat këta pedagogë janë të angazhuar me kohë të plotë për lidhjen e kontratave me AU).

Nga një analizë e ngarkesës mësimore planifikuar për personelin akademik të angazhuar në programin e studimit MSc në "Teknologji Informacioni" [Evidencë 32] rezulton se ka një ngarkesë të

lartë për një numër pedagogësh (që arrin deri në mbi 700 orë) [Evidencë 32]. Kjo edhe për shkak të angazhimit edhe në programe të tjerë studimi që mbulohen nga Departamenti i Inxhinierive apo edhe nga departamente të tjerë. Gjithashtu numri i lëndëve të zhvilluar nga një pedagog në mjaft raste është shumë i lartë (në ndonjë rast shkon deri në 10 lëndë).

Një situatë e tillë potencialisht mund të ketë ndikim negativ në cilësinë e mësimdhënies dhe në angazhimin e personelit akademik në detyra të tjera si udhëheqja e diplomave dhe në kërkimin shkencor.

Nga një analizë e tabelave me të dhëna për stafin akademik sipas moshës dhe titujve e gradave [Evidencë 2, tabela 5], vërehet se përgjithësisht kemi të bëjmë me staf akademik efektiv (PAE) relativisht të ri në moshë (100% e PAE me tituj e grada është nën 45 vjeç). Një element i tillë është pozitiv për një zhvillim të qëndrueshëm të Departamentit dhe një dinamikë pozitive në drejtim të kërkimit shkencor (aplikimit dhe pjesëmarrjes në projekte kërkimore).

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Senati Akademik i AU me Vendimin Nr.24 datë 13/12/2017 [Evidencë 34] ka kërkuar marrjen e masave të menjëherëshme për të rekrutuar staf efektiv dhe për të siguruar qëndrueshmërinë e tij. Për këtë u vendos shpallja e vendeve vakante për personel akademik efektiv jo vetëm në fillim të vitit akademik, por edhe përpara fillimit të semestrit të dytë.

Zyra e Burimeve Njerëzore e AU në bashkëpunim me Zyrën Juridike kanë rishikuar paraprakisht përmbajtjen e kontratave të punës të stafit akademik me kohë të plotë (PAE) si dhe me kontratë (PAK) në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë [Evidencë 35].

Më konkretisht në kontrata ndryshimet konsistojnë në:

- Të drejtën e stafit akademik me kohë të plotë për të kërkuar një financim nga AU për një aktivitet shkencor brenda ose jashtë vendit ose botim shkencor në fushën që përbën prioritet për njësinë bazë përkatëse;
- Të drejtën e shkëputjes nga angazhimet e institucionit për kryerjen e vitit sabbatik një herë në shtatë vjet me miratimin e njësisë bazë, për periudha kohore deri në një vit, për të punuar për përparimin akademik;
- Për kategorinë Profesor dhe Lektor me kontratë (PAK) është përcaktuar kohëzgjatja pa afat e kontratës së punës, me të drejtë ripërtëritje çdo vit në momentin e paraqitjes së lejes nga punëdhënësi.
- Kontratat e stafit akademik me kohë të plotë (PAE) për të gjitha kategoritë janë me afat të pacaktuar.

Kontratat që nënshkruhen me pedagogët efektivë dhe ata me kontratë administrohen nga zyra e Burimeve Njerëzore e cila është përgjegjëse jo vetëm për arkivimin e dokumentacionit dhe ruajtjen e tij në vite, por edhe për gjenerimin e statistikave vjetore. Në fillim të secilit vit akademik/semestër zyra e burimeve njerëzore bën përditësimin e informacionit mbi stafin akademik. Nga takimi i realizuar në Zyrën e Burimeve Njerëzore nga GVJ dhe verifikimi i procedurës së rekrutimit për një numër rastesh [Evidencë shënimet gjatë vizitës] rezulton se ndiqet procedura e parapërcaktuar për hartimin e kriterëve, ngritjen e komisionit të vlerësimit, regjistrimin e kandidatëve, intervistimin e tyre, shpalljen e fituesit dhe lidhjen e kontratës.

Një politikë e tillë ka dhënë rezultate pozitive në drejtim të rekrutimit të stafit akademik dhe shërben si një bazë solide për një zhvillim të qëndrueshëm të tij.

Në këtë mënyrë, gjatë vitit akademik 2017-2018 janë rekrutuar dy pedagogë efektivë (me gradën Dr.) Megjithatë mbetet akoma për të bërë në drejtim të rekrutimit të personelit akademik efektiv për të mundësuar uljen e ngarkesës në kufij të pranueshëm.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Personeli akademik dhe administrativ i institucionit është i angazhuar në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre.</p> <p>Personeli akademik dhe administrativ i institucionit është i angazhuar në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. Performanca e mësimdhënies kontrollohet në mënyrë periodike në të gjitha aspektet duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse [Evidencë 86].</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Vendimet për hartimin dhe rishikimin e kurrikulave merren me propozim të njësisë bazë, departamentit [Evidencë 52].</p> <p>Çdo anëtar i departamentit ka të drejtë të bëjë propozime dhe të argumentojë përpara kolegëve ndryshimet e propozuara. Nëse vendimi miratohet në nivel departamenti, kalon për miratim në instancat më të larta të Këshillit të Fakultetit e më pas në Senatin Akademik.</p>
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të</p>	<p>Albanian University i ka të përcaktuara në dokumentacionin bazë që rregullon veprimtarinë e institucionit, parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme [Evidencë 36].</p> <p>Personeli akademik efektiv(PAE) i angazhuar në programin e studimit MSc në “Teknologji Informacioni” përbën rreth 67% të personelit akademik total, ndërsa ngarkesa mësimore e realizuar nga personeli akademik efektiv(PAE) është në masën 74% [Evidencë 32].</p>

<p>raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>AU ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit. Për pedagogët, kryhet vlerësim edhe nga studentët si dhe ndiqet progresi i tyre nga ana e Përgjegjësit të Departamentit. Zyra e Burimeve Njerëzore ka një bazë të dhënash për të gjithë procesin e rekrutimit të personelit dhe njoftimeve për punë.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjësi i Departamentit, Dr. Genta Rexha, që është dhe përgjegjëse e programit të studimit MSc në “Teknologji Informacioni” ka gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë “Universitetit të Dytë të Napolit” (Itali) dhe me eksperiencë kërkimore në Institutin e Motorave në Napoli, pjesë e Qendrës Kombëtare të Kërkimit Shkencor në Itali [https://albanianuniversity.edu.al/staff-members/dr-genta-rexha/].</p> <p>AU angazhon kryesisht si titullarë të lëndëve, moduleve personel akademik i cili minimalisht ka gradën shkencore Doktor [Evidencë 132]. Drejtuesit e njësive, Rektori, zv/Rektori, Dekani, Zv/Dekani, si dhe Përgjegjësi i Departamentit, janë të punësuar me kohë të plotë në AU. Personeli akademik i Departamentit të Inxhinierive mbulon zhvillimin e praktikave profesionale [Evidencë 30] si dhe të projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	

<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p>	<p>Të gjithë studentët që ndjekin këtë program studimi, gjatë programit të studimeve përgatisin dhe mbrojnë një punim diplome nën drejtimin e një udhëheqësi [Evidencë 45].</p>
<p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informatike” përcaktohet se udhëheqësi i diplomës duhet të ketë gradën shkencore “Doktor” [Evidencë 45, Neni 32].</p>
<p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht [Evidencë 45, Neni 32] (duhet theksuar se për vitin akademik 2017-2018 janë mbrojtur vetëm 4 diploma)</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p>	<p>Departamenti gjatë shqyrtimit të propozimeve për temën e diplomës garanton që udhëheqësi i propozuar të jetë në përputhje me fushën e programit të studimit dhe temën e propozuar [Evidencë 45, Neni 32].</p>
<p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Në se nuk ka pedagogë të brendshëm të përshatshëm për të udhëhequr një temë të caktuar, atëherë Departamenti ka të drejtë të caktojë një pedagog të jashtëm brenda kritereve të kërkuara.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV dhe vizitës në institucion rezultoi se personeli ndihmës akademik (2 anëtarë) i angazhuar për zhvillimin e orëve laboratorike ka kualifikimin e duhur dhe punon jo vetëm në mbështetje të realizimit të procesit mësimor, por edhe për mirëmbajtjen e bazës laboratorike (e cila është një bazë laboratorike bashkëkohore). Kryesisht seancat laboratorike kryhen nga personel akademik me përgatitje të plotë për zhvillimin e lëndëve laboratorike, duke punuar me grupe të vegjël studentësh.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Personeli akademik është i angazhuar për përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Departamenti kontrollon dhe vlerëson punën e tyre nëpërmjet anketimeve të kryera me studentët [Evidencë 20, Evidencë 22].</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet</p>	

ligjore e nënligjore në fuqi.

Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;

Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ është i mendimit se ngarkesa mësimore realizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe kontratës së lidhur me AU.

Megjithatë duhet theksuar fakti se përgjithësisht pedagogët efektivë të angazhuar në këtë program studimi kanë një ngarkesë relativisht të lartë (që në ndonjë rast arrin deri në mbi 700 orë) [Evidencë 32].

Kjo edhe për shkak të angazhimit edhe në programe të tjerë studimi që mbulohen nga Departamenti i Inxhinierive apo edhe nga departamente të tjerë.

Gjithashtu numri i lëndëve të zhvilluar nga një pedagog në mjaft raste është shumë i lartë (në ndonjë rast shkon deri në 10 lëndë).

Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programin e studimit MSc në "Teknologji Informacioni" si dhe organizimi e drejtimi i tij, vlerësohen me orë mësimore (shih aneksin).

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

Gjatë vizitës së GVJ në zyrën e burimeve njerëzore rezultoi se AU ka një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik.

AU disponon një informacion të përditesuar për personelin akademik. Për çdo vit akademik përcaktohet safi akademik që do të angazhohet (i ndarë sipas semestrave) dhe lidhen kontratat me PAK.

Kriteret shpallen publikisht shpallen nëpërmjet Shërbimit Kombëtar të Punësimit [Evidencë shtesë 5], televizionit të AU dhe faqes web të AU [<https://albanianuniversity.edu.al/sq/vende-vakante/>] dhe përzgjedhja bëhet me konkurs shoqëruar me intervistim të kandidatëve.

Konkluzionet e vlerësimit:

- Gjatë vitit të fundit akademik ka patur rekrutim të personelit akademik efektiv duke bërë të mundur rritjen e numrit të personelit akademik me tituj e grada si dhe përmirësimin e raportit PAE/PAK.
- Megjithatë, duke patur parasysh angazhimin e personelit akademik edhe në programe të tjera studimi që mbulon Departamenti, rekomandohet ulja e ngarkesës mësimore si dhe e numrit të lëndëve të zhvilluara nga një pjesë e tyre në kufij të pranueshëm. Kjo mund të realizohet duke vazhduar me procesin e rekrutimeve të PAE.

- Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën 2/3 e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit, ndërsa pjesa i përket ngarkesës mësimore të realizuar, ajo mbulohet në një masë që e kalon kufirin 70% nga personeli akademik efektiv, ndaj mund të konsiderohet që ky kriter respektohet.
- Personeli akademik me kontratë, paraqet qëndrueshmëri në vite dhe duke qenë personel i kualifikuar ka treguar përkushtim në realizimin e programit.
- AU ka të dhëna të detajuara pjesa i takon personelit akademik të angazhuar, formën e punësimit dhe ngarkesën e realizuar. AU ndjek procedura transparente për rekrutimin e personelit mësimdhënës. Vështirësi paraqiten në rekrutimin e personelit akademik me kualifikimin e kërkuar.

Standardet e kësaj fushe janë përmbushur kryesisht

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Departamenti i Inxhinierive si njësi bazë e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike zhvillon aktivitetin e tij në godinën e cila ndodhet në adresën “Rruga e Kavajës”. Godina e cila është në shërbim të gjithë programeve të studimit të Fakultetit, ka ambientet e saj të përshtashme për shvillimin e procesit mësimor (përfshirë edhe seancat laboratorike) si dhe ofron shërbime suplementare si bibliotekë, zyrë informacioni për studentët, mjedis çlodhës (kafeteri), mjedis për fotokopjime, nyje higjeno-sanitare etj. [Evidencë 27].

Nga vëzhgimi i ambienteve, GVJ konstaton se ato janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor. Sallat e leksioneve janë të paisura me mjetet e nevojshme didaktike si videoprojektor, ekrane projektimi etj. Mënyra e realizimit të mësimdhënies bazohet në metoda e teknologji bashkëkohore.

Në funksion të programeve të studimit të ofruara nga Departamenti i Inxhinierive, institucioni ka ngritur labororet mësimore si më poshtë [Evidencë 82]:

- Laboratorët e Informatikës 1 – 2 (Simulimeve),
- Laboratori i Infrastrukturës së Rrjetave,
- Laboratori i Fizikës,
- Laboratori i Kimisë,
- Laboratori i Elektroteknikës,
- Laboratori i elektronikës analoge/laboratori i elektronikës dixhitale,
- Laboratori i matjeve elektrike dhe elektronike,
- Laboratori i automatikës dhe kontrollit (dhe Mekatronikës),
- Laboratori i makinave elektrike.

Këta laboratorë janë të pajisur me aparatura dhe pajisje bashkëkohore në përputhje me kërkesat e programeve të studimit të Departamentit. Në mënyrë të veçantë, në funksion të programit të studimit MSc në “Teknologji Informacioni” shfrytëzohen labororet e simulimeve dhe infrastrukturës së rrjetave.

Biblioteka në dispozicion të studentëve të Fakultetit, e cila funksionon në orarin 8.00 - 16.00 nga e hëna deri të premten dhe në orarin 8:00 – 12:00 ditën e shtunë, ofron një numër titujsh për të mbuluar

programin e studimit të ofruar. Synohet disponibiliteti i literaturës bazë në gjuhën shqipe, por shfrytëzohen edhe libraritë elektronike të cilat përmbajnë libra apo botime shkencore në drejtim të teknologjisë së informacionit. Përgjithësisht për secilën lëndë apo njësi lëndore, pedagogu i udhëzon studentët për literaturën bazë dhe për literaturën e rekomanduar [Shënime gjatë vizitës]. Literatura bazë është kryesisht ajo që përdoret edhe në Universitete të tjera publike e private në gjuhën shqipe. Në literaturën bazë rekomandohen edhe tekste të përkthyer nga shtëpi të ndryshme botuese, si dhe tekste në gjuhë të huaj. Në çdo rast, pedagogu u ofron studentëve leksionet e tij të shkruara [Shënime gjatë vizitës]. Literatura ndihmëse është gjithashtu e parashikuar dhe e pasqyruar në syllabusin e çdo lënde [Evidencë 132].

Biblioteka e Fakultetit, e cila shërben njëkohësisht edhe si sallë interneti dhe si mjedis për fotokopjime, ka një kapacitet relativisht të kufizuar.

Në bibliotekë gjenden rreth 100 tituj librash në fushat inxhinierike me rreth 330 kopje [Evidencë 76]. Vetëm në vitin akademik 2017-2018 biblioteka është pasuruar me 119 kopje [Evidencë 76]. Në bibliotekë janë të instaluar 25 terminale të lidhura në një kompjuter qëndror, të cilët vihen në dispozicion të studentëve, duke i mundësuar atyre kërkimin në internet dhe aksesimin e librarive online [Evidencë 77] të këshilluara nga departamenti.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qëndror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike zhvillon aktivitetin e tij në godinën e cila ndodhet në adresën “Rruga e Kavajës”. Godina e cila është në shërbim të gjithë programeve të studimit të Fakultetit, ka ambientet e saj të përshtashme për shvillimin e procesit mësimor (përfshirë edhe seancat laboratorike) si dhe ofron shërbime suplementare si bibliotekë, zyrë informacioni për studentët, mjedis çlodhës (kafeteri), mjedis për fotokopjime, nyje higjieno-sanitare etj. Mjediset janë në dispozicion të institucionit për një kohë 10 vjeçare [Evidencë 27].</p> <p>Programi i studimit MSc në Teknologji Informacioni zhvillohet tërësisht në godinën e cila ndodhet në adresën “Rruga e Kavajës”.</p> <p>Sipas RVB, si dhe nga diskutimet me studentë e pedagogë të programit të studimit rezultojnë se praktikat profesionale realizohen në institucione shtetërore apo private [Evidencë 106, Evidencë 115]. Këto bashkëpunime janë konkretizuar përmes marrëveshjeve të shkruara. Eventualisht problem mbetet qëndrueshmëria e tyre në kohë.</p>

Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;

Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;

Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;

Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.

Gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët GVJ konstatoi se pedagogët u rekomandojnë studentëve tekste mësimore që shërbejnë si literaturë bazë si dhe leksione dhe materiale të tjera ndihmëse [Shënime gjatë vizitës].

Gjatë vizitës tek biblioteka u konstatua se disponibiliteti i literaturës bazë në gjuhën shqipe, por shfrytëzohen edhe libraritë elektronike [Evidencë 77] të cilat përmbajnë libra apo botime shkencore në drejtim të teknologjisë së informacionit. Vëmendja e shtuar ndaj bibliotekës, bazuar edhe në konstatimet e akreditimit të mëparshëm, ka bërë që të ketë një pasurim të konsiderueshëm të saj me tituj në shërbim të programit të studimit [Evidencë 76].

Bazuar në azhornimet vjetore të programeve të lëndëve nga ana e pedagogëve titullarë, hartohet plani i detajuar (dhe buxheti përkatës) me librat e rinj me të cilët konsiderohet e nevojshme të pasurohet biblioteka [Evidencë 26], për t'ju ardhur në ndihmë studentëve dhe për t'i mbajtur të azhornuar me zhvillimet më të fundit të programeve përkatëse.

Biblioteka është në dispozicion të studentëve në orarin 8.00 - 16.00 nga e hëna deri të premten dhe 8:00 - 12:00 ditën e shtunë dhe, me përjashtim të ditës së shtunë, nuk përputhet mirë me oraret e zhvillimit të seancave mësimore (duke qenë se mësimet për programin e studimit zhvillohen pasdite).

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të

Konstatimi i GVJ është se mjediset aktuale janë të përshtatshme dhe me hapësira funksionale për zhvillimin e të gjitha veprimtarive universitare. Ndërtesa e venë në dispozicion të Fakultetit është e pajisur me salla leksionesh, seminaresh, konferencash, laboratorësh të informatikës dhe të inxhinjerisë të nevojshëm për realizimin e programit të studimit.

Mjediset mësimore janë të pajisur me mjetet e nevojshme për një mësimdhënie cilësore në përputhje me qëllimet dhe objektivat e programit të

studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

studimit.

Laboratorët e nevojshëm për zhvillimin e programin të studimit MSc në “Teknologji Informacioni”, janë kryesisht laboratorë virtualë, ku punohet në kompjuter nëpërmjet përdorimit të programeve të ndryshme të simulimit. Praktikave profesionale zhvillohen kryesisht në institucione të tjera shtetërore apo private [Evidencë 106].

Për realizimin e programit të studimit MSc në “Teknologji Informacioni” përdoret kryesisht laboratorit i informatikës, ku janë instaluar programet e ndryshme që përdoren për kryerjen e praktikave laboratorike në trajtën e simulimeve. Një zhvillim pozitiv në këtë drejtim përbën investimi në paisjen e Laboratorit të Infrastrukturës së Rrjetave [Evidencë 25] duke përmirësuar në këtë mënyrë bazën laboratorike në shërbim të programit të studimit.

Konkluzionet e vlerësimit:

- Mjediset aktuale janë të përshtatshme dhe me hapësira funksionale për zhvillimin e të gjitha veprimtarive universitare. Infrastruktura që është në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson standartet dhe kriteret e cilësisë. Godina, disponon një infrastrukturë moderne. Sallat e leksioneve janë të paisura me videoprojektor. Laboratorët e informatikës janë të paisur me programet e nevojshme të përcaktuar në programin mësimor. Laboratorët mësimorë janë të kompletuar rishtas duke u paraqitur me paisje të reja bashkëkohore për zhvillimin cilësor të seancave praktike.
- Biblioteka përgjithësisht ofron kushte të mira. Fond i botimeve ka ardhur duke u pasuruar duke mbuluar në një masë të madhe lëndët me literaturën bazë. Veç kësaj mund të shfrytëzohen edhe bibliotekat on-line si dhe libraritë elektronike të cilat përmbajnë libra apo botime shkencore në drejtim të teknologjisë së informacionit.
- Kryerja e praktikave profesionale realizohet në institucione të tjera shtetërore apo private me të cilat janë lidhur marrëveshje.

Standardet e kësaj fushe janë përmbushur.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Burimet financiare të universitetit janë kryesisht nga tarifat e shkollimit. Të gjitha këto të ardhura shkojnë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e strukturave menaxhuese. Në rang universiteti ka një njësi e cila merret me menaxhimin e burimeve financiare, dhe kontrollin e tyre.

Rreth 1/3 e burimeve të të ardhurave shpenzohet për qiranë e objektit dhe shërbime të tjera të lidhura me të (mirëmbajtja, pastrimi, ngrohja, ftohja, etj.) [Evidencë 2, faqe 17].

Pjesë tjetër e burimeve të të ardhurave shpenzohet për pagesën dhe sigurimet e punonjësve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me reklamën, shërbimin internet, pajisjet e aparaturat, mjetet e konsumit dhe detyrimet ndaj shtetit.

Të ardhurat dhe financimet në institucion regjistrohen, përpunohen dhe auditohen mbi bazën e një numri unik identifikues (NIPT-i) të lëshuar nga QKR.

Institucioni ka një raport financiar për çdo vit buxhetor të hartuar dhe certifikuar nga ekspertë të jashtëm (audit i jashtëm) [Pasqyra financiare 2017, Pasqyra financiare 2016, Raport eksperti kontabël]. Nga analiza e pasqyrave financiare rezulton se për tre vitet e fundit marrë në konsideratë institucioni rezulton me fitim të qëndrueshëm. Në këtë mënyrë institucioni nga pikpamja financiare garanton zhvillimin e tij perspektiv.

Sipas RVB [Evidencë 2, faqe 17], kostoja për një student në programin e studimit *Master i Shkencave* në Teknologji Informacioni është 124 000 lekë.

Eventualisht institucioni mund të punojë në drejtim të diversifikimit të burimeve të financimit, duke mos u kufizuar vetëm tek tarifat e shkollimit, por duke ofruar shërbime për të tretët, duke u angazhuar në projekte shkencore si dhe eventualisht projekte zbatimi.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>AU bën një audit të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare, e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik.</p> <p>Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet dhe të ardhurat (duke ju referuar bilancit). Aktualisht universiteti nuk përfiton ndonjë grant të huaj.</p> <p>Raporti i auditit përmban një pasqyrë të hollësishme referuar bilancit për të ardhurat dhe shpenzimet.</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të</p>	<p>AU harton raportin e bilancit të të gjithë shoqërisë çdo vit në të cilin parashikohen të dhëna të hollësishme financiare për të ardhurat dhe kostot. Ky raport disponohet nga zyra e financave të universitetit.</p> <p>AU i ka të dokumentuara raportet financiare për të tri vitet e fundit [<u>Pasqyra financiare 2017</u>, <u>Pasqyra financiare 2016</u>, <u>Raport</u></p>

ardhurave në të ardhmen.	eksperti kontabël]. AU dëshmon një qëndrueshmëri financiare. Eventualisht, në të ardhmen, mund të punohet në drejtim të diversifikimit të burimeve të financimit.
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - Në mënyrë të përvitshme hartohet një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve; - Çdo vit, AU bën një auditim të jashtëm për sa i përket situatës financiare; - Duke iu referuar raportit financiar zyrtar AU ka një bilanc vjetor pozitiv, i cili garanton ecurinë perspektive të programeve të studimit. - Ka rritje të të ardhurave (por që lidhet me rritjen e numrit të studentëve); - Konstatohet qëndrueshmëri financiare e AU, por eventalisht mund të punohej në drejtim të diversifikimit të burimeve të financimit. <p>Standardet e kësaj fushe janë përmbushur</p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Mbështetur në dokumentacionin në RVB, dokumentacionin mbështetës të AMS dhe gjatë vizitës në institucion rezultojnë se: "Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë" është ngritur dhe funksionon në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar mbi arsimin e lartë si dhe dispozitat e Statutit të AU dhe të Rregullores Mësimore. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë në AU funksionon nëpërmjet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) [Evidencë 43 neni 14] dhe shtrihet deri në nivel Departamenti [Evidencë 83, Evidencë 84]. NJSBC rezultojnë të jetë në varësi të Rektoratit të Universitetit [Evidencë 66], dhe ka për detyrë paraqitjen e raporteve semestrale dhe vjetore në të cilët përfshihen informacione dhe vlerësime për procesin e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar, si dhe rekomandon masa për përmirësimin e parametrave të cilësisë në të ardhmen.

NJSBC është e përbërë nga 4 anëtarë (Tabela 6, Aneksi 1), nga të cilët dy janë përfaqësuesit në nivel Departamenti. Eventualisht kjo zyrë mund të plotësohet edhe me një student për të dhënë frymën e gjithë përfaqësimit.

Nga takimet me pedagogë dhe përfaqësues të zyrës së NJSBC, rezultojnë se në nivel njësie bazë, në fillim të çdo viti akademik, gjatë procesit të mësimdhënies, dhe në përfundim të tij të analizohen dhe të vlerësohen programet mësimore, literatura dhe format e vlerësimit. Kontrolli dhe vlerësimi bëhen në bazë të të dhënave statistikore të mbledhura gjatë anketimeve të studentëve, fokus – grupeve [Evidencë 19], raporteve të vetëvlerësimit të pedagogëve, raporteve semestrale [Evidencë 22] dhe vjetore të njësisë bazë [Evidencë 21], si dhe rezultateve të arritura nga studentët. Këto të dhëna statistikore vihen në dispozicion të NJSBC nga njësi bazë & sekretaria mësimore. NJSBC analizojnë të dhënat dhe nxjerrin në pah çështjet dhe situatat për përmirësim, me qëllim rritjen e performancës së mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, ndërveprimin të të gjithë faktorëve përbërës të Universitetit.

Gjatë vitit akademik 2017-2018 janë realizuar 2 anketime me studentët e programit të studimit MSc "Teknologji Informacioni", një në përfundim të semestrit të parë dhe një në përfundim të semestrit të

dytë. Në semestrin e parë kanë marrë pjesë në anketim rreth 50% e studentëve ndërsa në semestrin e dytë kanë marrë pjesë në anketime rreth 39% e studentëve.

Në përfundim të semestrit të parë 2017-2018 dhe në përfundim të vitit akademik Departamenti i Inxhinierive ka hartuar raportin semestral [Evidencë 22] dhe në përfundim të vitit akademik ka hartuar raportin vjetor [Evidencë 21], në të cilin përfshihen të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore, dhe në fund paraqitet analiza SWOT, si dhe vendosen detyra për përmirësime në të ardhmen. Në këto raporte kanë gjetur vend edhe rezultatet e përfuara nga anketimet e studentëve mbi punën e pedagogëve si dhe rezultatet e përfuara nga fokus-grupet, duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse.

Bazuar në RVB dhe në gjendjen e konstatuar gjatë vizitës, AU ka politika të qarta të vlerësimit të mbështetura në standartet e cilësisë. Nuk u evidentuan ndryshime ndërmjet të dhënave të deklaruara dhe atyre të konstatuara.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <p>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</p> <p>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</p> <p>c. Pyetje konceptuale;</p> <p>d. Intervista;</p> <p>e. Etj.</p> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <p>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të</p>	<p>Pas shqyrtimit të DVV dhe takimit me përfaqësuesit e NJSBC gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se, AU përdor metodologji vlerësimi për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë rektoratit, dekanateve dhe njësisive bazë të fakulteteve [Evidencë 86].</p> <p>AU rekomandon detyra, zbatimi i të cilave ndiqet nga ana e strukturave dhe vetë NJSBC. Informacioni i përftuar, e që menaxhohet nga NJSBC, bëhet pjesë edhe e raporteve të vetëvlerësimit, pjesë e të cilëve është edhe RVB i programit të studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni” duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë [Evidencë 2].</p> <p>Departamenti harton raportin semestral [Evidencë 22] dhe atë vjetor [Evidencë 21] në të cilin jepet në mënyrë të detajuar edhe plani i veprimit të njësise. Gjithashtu për çdo lëndë të zhvilluar bëhet vlerësimi i mësimdhënësit duke llogaritur në këtë mënyrë indeksin e performancës.</p> <p>Format e përdorura për vlerësim të performancës së trupës akademike, procesit mësimor, infrastrukturës dhe problematikave të jetës studentore janë:</p>

<p>standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</p> <p>b. Dëgjime në auditor;</p> <p>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</p> <p>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</p> <p>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	<p>- Fokus grupe (për vitin akademik 2017-2018 organizuar në dhjetor 2017);</p> <p>- Pyesorë për studentët: organizuar në fund të semestrit të parë dhe në fund të vitit akademik 2017-2018.</p> <p>Për vlerësimin e rezultateve të të nxënit përdoren forma të larmishme si testime ndërmjetëse dhe përfundimtare me notë, vlerësim i punimeve individuale, vlerësim i praktikave profesionale etj.</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>AU, në përfundim të çdo viti akademik, publikon në faqen zyrtare të tij, raportin vjetor të veprimtarisë mësimore dhe kërkimore – shkencore, duke përfshirë edhe analizën SWOT. http://albanianuniversity.edu.al/wp-content/uploads/2017/04/Raporti-Vjetor-NJSBC-2016-2017-Perfundimtar.pdf</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>AU harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve mësimore të ciklit të dytë duke i përmirësuar brënda hapsirave ligjore.</p> <p>AU përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë; nëpërmjet NJSBC. Rektorati kontrollon procesin e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve të tjera që universiteti kryen.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

AU ka kryer procedurat e akreditimit institucional dhe bazuar në Vendim e Bordit të Akreditimi nr. 90, dt. 20/10/2017 institucioni është akredituar për një kohëzgjatje 2 vjeçare (Vendim i Bordit të Akreditimi nr. 90, dt. 20/10/2017).

NjSBC dhe të ngarkuarit nga Departamenti për vlerësimin e cilësisë për programin e studimit Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni" përdorin instrumentët të shumëllojshme për mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit mbi cilësinë.

Institucioni ka një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik, çdo vit, nëpërmjet raporteve të vlerësimit dhe pyetësorëve në çdo fund të çdo semestri [Evidencë 22].

Programet e studimeve dhe syllabuset rishikohen çdo fillim viti akademik [Evidencë 51], [Evidencë 52], me pjesëmarrjen e grupeve të sigurimit të cilësisë në nivel Departamenti. Theksi vihet në përditësimin me literaturë bashkëkohore, ndryshimet në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe ndryshimet në legjislacion. Kjo realizohet në bashkëpunim edhe me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave dhe Komisionin për Mësimin dhe Kurrikulat.

Institucioni, nëpërmjet Departamentit, në fillim të çdo viti akademik në javët orientuese sqaron studentët dhe stafin akademik mbi rëndësinë e vlerësimit të cilësisë dhe akreditimit të programeve të studimit. Avantazhet dhe disavantazhet që kanë këta të fundit nga vlerësimi cilësor dhe akreditimi i programeve të studimit dhe vlerësimi institucional.

AU ka gjithmonë në vëmendjen e tij përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë mësimore dhe kërkimore - shkencore që ofron.

Sigurimi i cilësisë është pjesë e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit të Universitetit. Strategjia është e publikuar në faqen zyrtare të AU (<https://albanianuniversity.albaniancollege.edu.al/wp-content/uploads/2017/04/STRATEGJI-E-ZHVILLIMIT-INST.AU-2017-2022-1.pdf>)

Konkluzionet e vlerësimit:

Bazuar në RVB, vizitën në institucion dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion rezulton se:

- Në AU sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë është ngritur dhe funksionon me të gjitha strukturat në përputhje me kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë.
- Në nivel Departamenti, analizohen programet mësimore, literatura, sistemet e vlerësimit, para çdo fillimi të vitit të ri akademik dhe në vazhdim të tij.
- Në Departament janë institucionalizuar elementë të sistemit të sigurimit të cilësisë, është ngritur dhe funksionon një sistem i plotë i dokumentuar që të garantojë sigurimin e cilësisë në të gjitha aktivitetet e tij, në përputhje me standartet përkatëse.
- Nga bisedat me drejtuesen e Departamentit të Inxhinierive dhe me stafin akademik të programit të studimit u evidentua dëshira për nevojën e përsosjes së vazhdueshme të proceseve të garantimit të cilësisë.
- Prania e një kulture institucionale të vlerësimit kritik të vetvetes nëpërmjet organizimit të vlerësimeve të brendshme dhe planifikimit të përmirësimeve të nevojshme, që GVJ e gjeti të shprehur në prova dokumentare, janë garanci për qasjen objektive ndaj menaxhimit të cilësisë tani dhe në të ardhmen.

Standardet e kësaj fushe janë përmbushur

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni” në Albanian University, është licensuar me urdhër Nr.33, datë 31.01.2012 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe ofrohet me kohë të plotë dhe në gjuhën shqipe studentëve që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë “Bachelor” në përputhje me fushën e studimit dhe plotësojnë kushtet e pranimi specifikuar në Rregulloren e programit të studimit [Evidencë 127].

Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni” ju ofron studentëve njohuri të nevojshme për të përvetësuar kompetenca të avancuara shkencore dhe profesionale në fushën e Teknologjisë së Informacionit përmes metodave, instrumenteve dhe teknikave inovative.

Përvetësimi i këtyre aftësive bëhet i mundur në sajë të thellimit të njohurive, që studentët marrin në programet Bachelor në fushën e Inxhinierisë. Këto njohuri bazë thellohen më tej gjatë studimit në programet Master i Shkencave duke i zbatuar në planin metodologjik dhe aplikativ, në mënyrë që studentët të jenë në gjendje të zotërojnë kapacitetet e nevojshme për të përballuar problematikat e ndryshme të fushës së studimit, projektimin dhe zhvillimin e sistemeve të informacionit, si dhe për të dhënë kontributin përkatës në zhvillimin shkencor dhe teknologjik të këtij sektori [Evidencë 127].

Të diplomuarit në kuadër të këtij programi studimi do të marrin njohuri teoriko-praktike të nevojshme, me qëllim aftësimin e tyre:

- a) për të zhvilluar veprimtarinë në institucione publike dhe private, ku ka aparatūra të ndryshme, që shërbejnë për përpunimin e informacionit;
- b) për të zhvilluar veprimtarinë në mënyrë të drejtpërdrejtë në firma të ndryshme private të pajisura me sisteme informacioni etj.;
- c) pas një periudhe praktike në profesion dhe studimeve të avancuara, aftësinë për të drejtuar kualifikimin edhe përgatitjen e teknikëve dhe profesionistëve të ardhshëm në këtë fushë.

Duke parë zhvillimet e shpejta të teknologjisë sidomos në fushën e teknologjisë së informacionit dhe elektronikës, AU është përpjekur që të ndjekë këto hapa edhe me përmirësimin dhe përditësimin e programit mësimor në fjalë. Ky proces është diktuar në njëfarë mase edhe nga ndryshimet në aktet ligjore e nënligjore që kanë të bëjnë me arsimin e lartë. Programi i studimit është hartuar duke konsultuar eksperiencat më të sukseshme në vend dhe jashtë vendit për të qënë sa më pranë kërkesave të tregut të punës dhe nevojave të shoqërisë, në fushën e elektronikës dhe teknologjisë së informacionit.

Në mënyrë të veçantë, duke reflektuar dhe zhvillimet e shpejta në këtë fushë si dhe mangësitë e konstatuara gjatë akreditimeve të mëparshme, programi i studimit Master i Shkencave në "Teknologji Informacioni" është në proces rishikimi [Evidencë 33] nëpërmjet një procedure të iniciuar në Departament e duke kaluar në gjithë hallkat në AU [Evidencë 52] e duke u përcjellë për në miratimin nga MASR. Në përputhje me ndryshimet e propozuara në planin mësimor është kryer edhe rishikimi i syllabuseve të lëndëve përkatëse [Evidencë 53], [Evidencë 54].

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Nga analiza e ndarjes së ECTS sipas formave të mësimdhënies rezulton se për planin mësimor deri në vitin 2017-2018 përgjithësisht ka raporte të drejta ndërmjet formave të mësimdhënies. Përjashtim bën integrimi në një masë të pamjaftueshme i elementëve të tillë si detyra e projekte. Duhet theksuar se kjo është korrigjuar në propozimet e reja të planit mësimor që pritet të miratohen e të jenë aktive për vitin akademik 2018-2019 e në vazhdim.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

▪ Leksionet	9 - 11 orë në auditor dhe	16 - 14 orë punë e pavarur e studentit
▪ Seminaret	8 orë në auditor dhe	17 orë punë e pavarur e studentit
▪ Ushtrimet	15 - 16 orë në auditor dhe	10 - 9 orë punë e pavarur e studentit
▪ Laboratorët	15 - 16 orë në auditor dhe	10 - 9 orë punë e pavarur e studentit
▪ Detyrën e kursit	2 orë në auditor dhe	23 orë punë e pavarur e studentit
▪ Praktikën Profesionale	0 orë në auditor dhe	25 orë punë e pavarur e studentit
▪ Provimi përfundimtar	3.5 orë në auditor dhe	21.5 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Për vitin akademik 2017-2018 ndryshimet në planin mësimor në krahasim me atë të licënsuar janë minimale. Ndryshime më të mëdha (deri në 10%) në krahasim me planin mësimor aktual janë propozuar gjatë rishikimit të kurrikulës, inicuar në prill 2018.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Personeli akademik i angazhuar në zhvillimin e këtij programi studimi është personel akademik me tituj/grada dhe rreth 75% e lëndëve mbulohen nga PAE.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Syllabuset janë hartuar për çdo lëndë dhe përmbajnë këto elementë bazë:

- Emërtimi i modulit/lëndës
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Titullari dhe emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Tipi i lëndës në disipinat A-F
- Objektivat e lëndës, njohuritë që lënda ka për qëllim të japë.
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetësimin e lëndës.
- Të gjitha temat që trajton lënda në aspektin teorik dhe praktik.
- Forma e vlerësimit të studentit
- Detyrimet e studentit
- Literatura e detyrueshme dhe ajo ndihmëse.

GVJ i shqyrtoi të gjitha syllabuset përkatëse të lëndëve të programit mësimor dhe rezultoi se ato janë hartuar sipas formatit të kërkuar me elementët bazë të tyre [Evidencë 132]. Bazuar në DVV rezultoi se për një pjesë e mirë të syllabuseve mungon zëri detyra/projekte, por duhet theksuar që me rishikimin e planit mësimor pritet riorganizimi i tyre duke përfshirë edhe këta elementë. Përsa i përket përmbajtjes së tyre GVJ, vlerëson se ato japin plotësisht problematikën e lëndës duke iu përgjigjur objektivave të saj.

Duke gjykuar se syllabuset janë në proces përmirësimi të përhershëm, *GVJ rekomandon që ato të përshhtaten në mënyrë të vazhdueshme me kërkesat e tregut, zhvillimin e vrullshëm të teknologjisë së informacionit si dhe me eksperiencat më të mira të universiteteve vendase dhe atyre të huaja.*

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Ky program është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit, VBA nr. 37, datë 19.05.2017 për një kohëzgjatje një vjeçare. Ky program përfundon me diplomën Master i Shkencave dhe ofrohet i organizuar në module dhe i vlerësuar në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe grumbullimit të Krediteve (ECTS).
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Sasia e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student që ndjek këtë program

	studimi me kohë të plotë është 60 kreditë. Për të dy vitet e studimit, studenti duhet të grumbullojë së paku 120 kredite.
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni”, synon pajisjen e të diplomuarve me njohuri të thelluara praktike, duke synuar një orientim më fleksibël drejt nevojave specifike të tregut.</p> <p>Programi i studimit ofron një formim solid në sektor të ndryshëm me interes të Informacionit, duke integruar dhe zgjerimin e njohurive në fushën e përpunimit të informacionit dhe kontrollit dixhital, fushën e rrjetave të kompjuterave etj.</p> <p>Nuk ofrohen programe të integruara.</p> <p>Programi i studimit “Master i Shkencave” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoraturë, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor.</p>

Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni” nëpërmjet moduleve të lëndëve synon zgjerimin dhe thellimin e njohurive teorike, praktike dhe profesionale të studentëve si dhe njohjen e tyre me procesin e kërkimit shkencor. Modulet/lëndët e këtij programi ndërtohen mbi njohuri të fituara në ciklin e parë të studimeve dhe gjatë këtij cikli studimi studentët krijojnë baza të forta për vazhduar studimet në ciklin e tretë.</p> <p>Metodat e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara në syllabuset e lëndëve përkatëse. Studentët vlerësohen edhe nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive gjatë vitit akademik, duke mundësuar një vlerësim sa më objektiv për arritjet dhe nivelin e tyre të dijeve konform programit të studimit MSc në “Teknologji Informacioni”.</p>
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomatat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Nga takimet me pedagogët dhe Përgjegjësen e Departamentit [Shënime gjatë vizitës] rezulton se programi i studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni” është hartuar duke u mbështetur në përvojën e UPT dhe praktikatat më të mira të universiteteve më të mira të vendeve europiane si “Politecnico di Torino” etj.</p> <p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë. Kjo kontribuon në mundësinë e transferimit të krediteve e niveleve të studimit për në dhe nga universitete të tjera në Europë e më gjerë.</p>
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të</p>	<p>Aftësimi profesional i studentëve arrihet përmes kurrikulës që kombinon teorinë me aplikimin, me punësimin në procesin e mësimdhënies, të stafit me përvojë profesionale.</p> <p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë e Albanian University.</p> <p>Puna kërkimore-shkencore e personelit akademik dhe lidhja e saj me përditësimin e programeve të studimit janë komponentë të pranishëm në AU, i cili duhet të mbështesë më shumë kërkimin shkencor dhe të</p>

<p>studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>synojë ta kthejë në një komponent kryesor në mbështetje të formimit të Master i Shkencave.</p> <p>Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nëpërmjet RVB-së, dosjes përkatëse të universitetit, tregohet se AU inkurajon aktivitetet kërkimore-shkencore të departamentit.</p> <p>Megjithatë, për momentin, ngarkesa e lartë mësimore e personelit akademik vështirëson angazhimin e tyre cilësor në veprimtari kërkimore.</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Programi i studimit synon të kontribuojë në krijimin e një brezi të ri inxhinierësh, të formuar sipas nevojave të kohës, në përputhje me nevojat e tregut të punës. Ai është hartuar dhe synohet përmirësimi i tij në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit, përshtatjen e tij me zhvillimet teknologjike dhe përshtatjen me aktet ligjore e nënligjore.</p> <p>Në përputhje edhe me rekomandimet e akreditimeve të mëparshme, nga ana e Departamentit të Inxhinierive është kryer një studim tregu [Evidencë 61] shoqëruar me pytsorë drejtuar studentëve dhe bizneseve.</p> <p>Ndër konkluzionet e këtij studimi del se formën më të mirë të bashkëpunimit me IAL, bizneset e shohin përmes “pjesëmarrjes në programet e praktikës me IAL”. Dy veprimet kryesore që duhet të ndërmerren IAL-të për të përmirësuar punësimin e të diplomuarve të tyre, sipas bizneseve të intervistuar janë “të zhvillojnë kurse studimi më të përshtatshme për nevojat e punëdhënësve”, “të përfshijnë eksperiencën praktike në kurset e studimit”.</p> <p>Për IAL mbetet detyrë përforcimi i marrëdhënieve me bizneset, me qëllim krijimin e profilit të të diplomuarve sa më afër nevojave të tregut.</p> <p>Programi është ndërtuar duke synuar përgatitjen e specialistëve me kompetencat e kërkuara nga tregu i punës. Programi master shkencor kombinon teorinë me praktikën duke u mundësuar studentëve të zhvillojnë aftësi të reja ndërkohë që ata edhe praktikohen.</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	

<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>AU ofron programe studimi që janë në mbështetje të interesave kombëtare për një arsimim cilësor, me objektiv formimin e një brezi të ri intelektualësh.</p> <p>Programi Master është ndërtuar që t'i shërbejë ruajtjes së vlerave kulturore dhe interesave kombëtare, të tilla si demokracia, diversiteti, shpirti i sipërmarrjes, toleranca, bashkëpunimi, drejtësia, respektimi i të drejtave të njeriut, zhvillimi i qëndrueshëm, integrimi evropian.</p> <p>Programi i trajton, mbështet dhe i kultivon këto vlera nëpërmjet përmbajtjes mësimore, kërkimit dhe veprimtarive.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>Kohëzgjatja normale e studimeve në programin "Master i Shkencave në Teknologji Informatike" është 2 vjet i organizuar në 4 semestra, forma e studimit është studime me kohë të plotë dhe studentët për t'u diplomuar duhet të realizojnë 120 kredite ECTS.</p> <p>Në planin mësimor të këtij programi studimi parashikohet që studenti në përfundim të studimeve duhet të realizojë një tezë diplome e cila vlerësohet me 30 kredite.</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Syllabuset e të gjitha lëndëve u vihen në dispozicion studentëve në fillim të vitit akademik. Përmes tyre ata njihen me orët në auditor, ndarjen në leksione, seminare, laboratorë dhe praktika, detyrimet që lidhen me frekuentimin dhe detyrime të tjera që lidhen me shlyerjen e lëndës sipas programit përkatës.</p> <p>Informacioni për kurrikulën publikohet në fillim të vitit akademik në faqen web,</p> <p>(http://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-ekonomike-2/).</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p>	<p>Plani mësimor dhe detajimet në lidhje me mënyrën e realizimit të tij japin informacionin e nevojshëm për mënyrën e diplomimit [Evidencë 45].</p> <p>Studentët për t'u diplomuar duhet të realizojnë së</p>

<p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>paku 120 ECTS. Në planin mësimor të këtij programi studimi parashikohet që studenti në përfundim të studimeve duhet të realizojë një tezë kërkimi e cila vlerësohet me 30 kredite [Evidencë 45].</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

- Programi i studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni” është hartuar në përputhje me misionin dhe strategjinë e AU;
- Mësimdhënia zhvillohet në gjuhën shqipe duke përgatitur në këtë mënyrë kryesisht specialistë të aftë për tregun kombëtar të punësimit;
- Realizimi i programit mbështetet nga një staf PAE dhe PAK të motivuar dhe me nivel të lartë shkencor;
- Studentët disponojnë gjithë informacionin për programin e studimit dhe japin kontributin e tyre në përmirësimin e tij. Çdo fillim semestri atyre u vihen në dispozicion kalendari dhe llojet e lëndëve që do të zhvillohen;
- Këto programe së bashku me informacionin për kohëzgjatjen, ngarkesën, syllabuset dhe format e realizimit të tyre u dërgohen në rrugë elektronike të gjithë studentëve nga koordinatori i programit. Të dhëna të detajuara për programin e studimeve gjenden edhe në faqen e internetit të AU;
- Departamenti, sekretaria mësimore dhe asistenca e universitetit u vjen gjithmonë në ndihmë studentëve për çdo pyetje që këta të fundit ngrenë për programin e studimit apo çështje të tjera akademike të lidhura me këtë të fundit . Gjatë takimeve me studentët është konstatuar se shërbimi ka funksionuar rregullisht dhe me korrektësi duke përmbushur nevojat që ata kanë pasur.
- Lektori i lëndës në çdo fillim semestri shpjegon në mënyrë të detajuar përmbajtjen e lëndës, sistemin e vlerësimit për atë lëndë, detyrimet akademike për t’u vlerësuar, etj. Gjithashtu, departamenti çdo fillim viti jep informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër.
- *Rekomandohet përshtatja në mënyrë të vazhdueshme e syllabuseve me zhvillimin e vrullshëm të teknologjisë së informacionit si dhe me eksperiencat më të mira të universiteteve vendase dhe atyre të huaja.*

Standardet e kësaj fushe janë përmbushur

8. Mësimdhënia

Në AU procesi mësimor është i organizuar në vite akademike. Viti akademik zgjat 30 javë mësimore dhe 6 javë të parashikuara për sesionet normale të provimeve. Studenti zhvillon deri në 25 orë mësimore në auditor/javë. Koha e fillimit, mbarimit, sesionet e provimeve, pushimet e festave zyrtare përcaktohen në kalendarin akademik të miratuar nga Senati.

Format e mësimdhënies:

Format kryesore të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyrat ose projekte kurse, praktikat profesionale. Numri total i veprimtarive formuese është 19, ku janë parashikuar 17 provime, 1 praktikë dhe provimi i diplomës [Evidencë 16].

Lëndët klasifikohen në dy grupe kryesore:

lëndë të detyruara;

lëndë me zgjedhje njësoj të rëndësishme. Lëndët mund të jenë semestrale ose vjetore.

Ngarkesa dhe cilësia e realizimit:

Lëndët zhvillohen sipas orarit mësimor të shpallur [Evidencë shtesë 3], të ndërtuar mbi kritere pedagogjike me qëllim shpërndarjen e ngarkesës mësimore në mënyrë të balancuar.

Kontrolli i njohurive të studentëve [Evidencë 127]:

- Kontrolli i dijes së një lënde bëhet me cikle (module dhe provime). Kontrolli i dijes, si rregull, bëhet me shkrim [Shënimet gjatë vizitës].
- Në detyrimet e studentit përfshihen si lëndët e detyrueshme dhe ato me zgjedhje;
- Njohuritë e përfituara nga studenti, mund të kontrollohen dhe të vlerësohen përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, provimeve me shkrim, detyrave të kursit, punëve laboratorike.
- Vlerësimi në përfundim të secilës lënde bëhet me pikë (nga 0-100 pikë) dhe rezultati përfundimtar konvertohet me sistemin kombëtar të vlerësimit me notë, i cili është nga 4 – 10, ku 4 është notë jo kaluese dhe 10 është vlerësimi maksimal për njohuritë e përfituara si dhe shprehet me gërma nga A deri në F sipas sistemit të vlerësimit ECTS me notë.
- Në rregulloren e programit të studimi përcaktohen format e ndryshme të kontrollit të njohurive, të cilat zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti dhe që janë të detyrueshme për zbatim si nga pedagogët ashtu dhe nga studentët.
- Numri dhe lloji i lëndëve që duhen dhënë provim përcaktohet në planin mësimor.
- Modulet, provimet dhe riprovimet zhvillohen brenda afatit të caktuar në strukturën e vitit akademik. Datat e moduleve dhe të provimeve shpallen jo më vonë se dy javë para fillimit të sesionit.
- Studenti nuk pranohet në sesionin e parë të provimit të një lënde kur ka kryer më shumë se 25% mungesa në seancat mësimore (leksione/seminare/ushtime) të asaj lënde. Nëqoftëse ai ka kryer deri në 50 % mungesa në seancat mësimore të lëndës, atëherë ai pranohet në sesionin e dytë të provimit. Nëse ka kryer mbi 50 % mungesa në seancat mësimore të lëndës shpallet përsëritës në atë lëndë.

Metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies:

Metodat e mësimdhënies janë një ndërthurje e metodës klasike të shpjegimit në tabelë me projektme të materialeve mësimore të përgatitura nga pedagogët e lëndëve.

Stafi akademik dhe procesi mësimor janë në vlerësim periodik nga ana e studentëve (2 herë në vit), në mënyrë që përmes gjykimit të tyre të ketë ruajtje të cilësisë dhe përmirësim të vazhdueshëm të saj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Format e kontrollit të njohurive

Një nga format tipike të kontrollit të njohurive për lëndët Lëndët me leksione/ seminare/ laboratorë/ detyrë kursi paraqitet si vijon [Evidencë 2, faqe 33]:

17. 12

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Pjesëmarrja dhe aktivizimi në orët e seminareve	5%
Dorëzimi i detyrës së kursit	5%
Vlerësimi dhe pjesëmarrja në laboratorë	10%
Provimi i ndërmjetëm/Moduli	20%
Provimi përfundimtar	60%
Gjithsej	100%

Në mënyrë specifike format e kontrollit të njohurive jepen në syllabuset e lëndëve, ku sipas lëndës format e mësipërme të kontrollit të njohurive mund të paraqesin ndryshime të vogla nga ato të mësipërmet [Evidencë 132].

Ngarkesa totale e këtij programi studimi sipas formave të mësimdhënies jepet në tabelën në vijim [Evidencë 16]:

Programi i Studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informatike”	
Format e mësimdhënies	Orët totale në auditor
Leksione	559
Seminare	12
Ushtrime	274
Laboratore	148
Detyra Kursi	1
Praktikë profesionale	0
Tema e diplomës	100
Në total	1094

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Studentët janë të angazhuar në aktivitetin kërkimor të Departamentit kryesisht nëpërmjet elementëve kërkimorë që paraqesin temat e diplomave [Evidencë 75] si dhe nëpërmjet referimeve në aktivitete shkencore [Evidencë 11]. Veç kësaj, studentët janë të angazhuar në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies [Evidencë 88] dhe shprehjen e opinioneve të tyre për aspekte të ndryshme të jetës në universitet.

Bazuar në RVB, në gjëndjen e konstatuar gjatë vizitës në AU dhe dokumentacionin shtesë të marrë gjatë vizitës në institucion rezulton se ka politika të qarta përsa i përket mësimdhënies, të mbështetura në standartet e cilësisë. Nuk u evidentuan ndryshime ndërmjet të dhënave të deklaruara dhe atyre të konstatuara. Standardet e kësaj fushe janë përmbushur

9. Studentët

Nga vizitat në Sekretarinë mësimore, RVB dhe dokumentacioni i DVV, GVJ konstatoi se për vitin akademik 2017 – 2018, në programin e studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informatike”, në vitin e parë janë të regjistruar 28 studentë (27 të regjistruar për herë të parë me notë mesatare në hyrje 6.55), të cilët kanë rezultuar me një kalueshmëri 84.7% dhe notë mesatare

6.47. Në vitin e dytë nuk ka studentë të regjistruar (nuk ka patur studentë të regjistruar në vitin e parë për vitin akademik 2016-2017 bazuar në urdhërin Nr. 383, datë 08/07/2016 të MAS, për akreditimin me kusht të këtij programi studimi [Evidencë 130]).

Për të ndjekur programin e studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni”, studenti duhet të ketë përfutur një diplomë të ciklit të parë Bachelor, në përputhje me fushën e studimit. Numri minimal i studentëve për të hapur një program studimi është 3 studentë.

Çdo kandidat është i detyruar të plotësojë këto kritere [Evidencë 127, Neni 9]:

1. Të ketë një diplomë të ciklit të parë të studimeve Bachelor në përputhje me fushën e studimit ku ka grumbulluar 180 kredite ECTS.
2. Të plotësojë kriteret akademike të vendosura nga komisioni i pranimeve të njësisë bazë.
3. Të paguajë tarifën e caktuar vjetore.

Në rast se studenti ka përfunduar një diplomë tjetër jashtë disiplinës së përcaktuar më lart atëherë Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimeve të programeve i ngritur nga Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike vlerëson aplikimin duke patur në konsideratë këto kritere:

- Diploma e ciklit të parë të jetë e përputhshme të paktën në masën 60% me programin e studimit Bachelor në Teknologji Informacioni,
- Dosjen e kandidatit,
- Motivimin e tij për të ndjekur programin e studimit të kërkuar.

Pranimi i kandidatëve të rinj për të ndjekur studimet në ciklin e II-të të studimeve, dhe konkretisht në Programet e Nivelit të Dytë “Master i Shkencave në Teknologji Informacioni” në Albanian University është me dosje.

Studentët që paraqiten me dokumentacionin e mësipërm, nënshkruajnë një formular aplikimi, paguajnë në bankë tarifën e regjistrimit dhe më pas, nënshkruajnë kontratën [Evidencë 4].

AU mundëson transferimin e studentëve në vite ndërmjetëse brenda ciklit të dytë, midis programeve të njëjta ose të ngjashme studimi, si brenda të njëjtit institucion apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, private ose publike, vendase ose të huaja, si dhe lejon transferimin e studentëve të saj në shkolla të tjera të arsimit të lartë sipas procedurave të parashikuara në rregulloren mësimore [Evidencë 127] dhe në rregulloren e transferimeve [Evidencë 96]. Programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Inxhinierive krijojnë mundësi të mira transferimi në programet inxhinierike të ngjashme të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat në vend.

Numri total i të diplomuarve në programin e studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni” për vitin akademik **2017- 2018 është 4 studentë.**

Zyra e Karrierës dhe Alumnit ka pasqyruar të dhënat e punësimit të studentëve të diplomuar në 2 vitet e fundit (2016-2017 dhe 2017-2018), nga të cilat rezultojnë aktualisht të punësuar në përputhje me diplomën 16 të diplomuar dhe jo në përputhje me diplomën 7 të diplomuar. Gjithsej 23 të punësuar nga 29 të diplomuar në vitet akademike 2016 – 2017 dhe 2017 – 2018. [Evidencë shtesë 12].

Bazuar në RVB, në gjëndjen e konstatuar gjatë vizitës në AU dhe dokumentacionin shtesë të marrë gjatë vizitës në institucion rezulton se procedura e pranimit të studentëve zhvillohet në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi dhe se mbahen informacione të detajuara jo vetëm në raport me evolucionin e studentit në programin e studimit, por edhe në raport me punësimin. Nuk u evidentuan ndryshime ndërmjet të dhënave të deklaruara dhe atyre të konstatuara.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>AU zbaton kërkesat ligjore dhe kriteret të pranimit të institucionit si dhe kushtet e institucionit për diplomim.</p> <p>Pranohen vetëm ata studentë që zotërojnë një diplomë universitare Bachelor dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS.</p> <p>Pranimi bëhet në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë dhe të akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>Pranohen për t’u regjistruar në programin e studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave në Teknologji Informacioni, shtetasit shqiptarë dhe të huaj që plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në Rregulloren përkatëse të Programit të Studimit.</p> <p>Pranimi në programin e studimeve MSc. në Teknologji Informacioni kërkon nivelin minimal të njohjes së gjuhës së huaj atë B1 (Dëshmi e marrjes së njëres prej 5 gjuhëve të huaja sipas pikës 3 të nenit 78 të ligjit 80/2015 të certifikuar në nivelin internacional, sipas përcaktimeve të udhëzimit përkatës të MASR dhe akteve nënligjore në fuqi).</p> <p>Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit.</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si</p>	<p>Informacioni për mundësitë për punësim pas diplomimit, në përfundim të këtyre programeve të studimeve, u jepet studentëve në forma të ndryshme. AU u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Studentëve u bëhet e njohur</p>

edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;

Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.

informacioni mbi akreditimin e programit që në kontaktin e parë me institucionin.

AU ka marrëveshje bashkëpunuese me shoqëri tregtare private, me të cilat realizon edhe kryerjen e praktikës profesionale. Marrëdhëniet që vendosin studentët me këto shoqëri gjatë viteve të studimit janë të tilla që krijojnë marrëdhënie njohje reciproke me punëdhënësin çka mund të çojë pas diplomimit edhe në mundësi punësimi.

Nëpërmjet “Zyrës së Karrierës dhe Alumnit”, personeli akademik, ndihmës mësimesh shkencor dhe personeli administrativ janë angazhuar për informimin e studentëve mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi si dhe për zbatimin e kësaj politike.

Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;

Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;


Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.

AU disponon statistika për numrin e të diplomuarve dhe studentëve që pritet të diplomohen. Fakulteti nëpërmjet Sekretarisë Mësimore dhe Departamentit të Inxhinierive, disponon statistika vjetore të studentëve që ndjekin programin e studimit, por edhe të studentëve që do të diplomohen këtë vit akademik.

Institucioni ka të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.


AU ka statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërhequr dhe largimin para përfundimit të programit dhe mospërfundimin me sukses të vitit akademik. AU nëpërmjet Sekretarisë Mësimore disponon të gjitha të dhënat e nevojshme për pranimin dhe diplomimin e studentëve në programin e studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni”. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë Master i Shkencave si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin e vitit

	<p>akademik.</p> <p>Të dhënat janë të regjistruara në Regjistrin Themeltar, në Regjistrin e Indeksit, në Regjistrin e Rezultateve Akadematike, në Regjistrimin e Diplomave, të verifikuar në Sekretarinë Mësimore.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>AU përmes Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, përmes kontakteve telefonike dhe komunikimit me e-mail me të diplomuarit, ka hartuar një bazë të dhënash mbi punësimin e tyre [Evidencë shtesë 12].</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët e programit të studimit MSc në “Teknologji Informacioni” nëpërmejt Sekretarisë mësimore, pedagogëve të lëndëve dhe Departamentit informohen në lidhje me programet e studimeve të zgjedhur prej tyre, afatin e përfundimit të programit, mënyrën e organizimit të programit të lëndëve përkatëse si dhe statusin e akreditimit të programeve. Gjithashtu këto të dhëna janë të publikuara në faqen web të AU (https://albanianuniversity.edu.al/sq/fakulteti-i-shkencave-te-aplikuara-dhe-ekonomike-2/)</p> <p>Studentët informohen për rezultatet e fituara në lëndët e programit përgjatë dhe në përfundim të programit mësimor. Gjatë semestrit studentët vlerësohen në detyrat e parashikuara për të cilat marrin edhe transparencën e kërkuar.</p> <p>Pas çdo provimi publikohen rezultatet paraprake për çdo student. Studentëve u lihet një afat për ankimimet e mundshme lidhur me rezultatet e provimit [Evidencë 127, Neni 21, 26, 27]. Pedagogu i çdo lënde diskuton me studentët për rezultatet e këtyre</p>



	vlerësimeve. Nota përfundimtare vendoset mbas këtij procesi.
Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>AU u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës [Evidencë 97]. Nëpërmjet Zyrës së Koordinimit dhe Mbështetjes për Studentët, AU ndjek politikë mbështetëse për studentët, nëpërmjet veprimtarive të orientimit dhe të tutoratit.</p> <p>Kjo zyrë, nëpërmjet Departamentit, menaxhon dhe mbikëqyr takimet e përcaktuara e të planifikuara të pedagogut përgjegjës me grupet e studentëve.</p> <p>Nëpërmjet Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, studentët informohen mbi mundësitë për kryerjen e praktikave profesionale pranë shoqërive dhe institucioneve me të cilat AU ka marrëveshje bashkëpunuese për kryerjen e praktikës profesionale.</p> <p>Marrëdhëniet që vendosin studentët me këto shoqëri gjatë viteve të studimit janë të tilla që krijojnë marrëdhënie njohje reciproke me punëdhënësin çka mund të çojë pas diplomimit edhe në mundësi punësimi.</p>
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u>	
<ul style="list-style-type: none"> - AU, Fakulteti i Shkencave Aplikuar dhe Ekonomike, Departamenti i Inxhinierive i kushtojnë një vëmendje të veçantë studentit, duke e ndjekur, këshilluar e orientuar që në procesin e regjistrimit e deri në atë të punësimit. - Nga ana GVJ u evidentua se Departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Karrierës dhe Alumnit dhe Sekretarinë Mësimore disponon të gjitha statistikat e nevojshme për këtë program studimi. - Departamenti bashkëpunon me Sekretarinë Mësimore dhe Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve për të informuar dhe koordinuar studentët dhe stafin akademik për një procedim sa më efektiv të të gjithë procesit mësimor. - AU vë në dispozicion të studentëve të interesuar për të ndjekur master shkencor grupe pedagogësh, sipas drejtimit të programit, për të dhënë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit, rregulloren e universitetit, mundësitë e punësimit, mundësitë e transferimit të krediteve, etj. Një rol të veçantë luajnë Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes së Studentëve dhe Zyra e Karrierës dhe Alumnit, të cilat me aktivitetet e tyre mbulojnë kërkesat e studentëve dhe shërbejnë si një urë e mirë dhe e qëndrueshme lidhjeje ndërmjet studentëve që përfundojnë studimet në AU dhe punëdhënësve. - Duhet të bëhet më shumë për të përthithur student me rezultate të larta, kjo do të rriste më shumë nivelin e studentëve të diplomuar si dhe do të sillte cikle të reja studimi Doktoraturë, punime shkencore nga ana e studentëve etj. 	

T F.



KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Sipas RVB dhe diskutimeve gjatë vizitës në vend, AU është institucion i arsimit të lartë i orientuar nga mësimdhënia dhe kërkimi shkencor. Veprimtaria kërkimore shkencore në Universitetin AU është e organizuar dhe zhvillohet në zbatim të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Sipas statutit [Evidencë 65] AU synon që kërkimi shkencor të jetë pjesë e integruar e veprimtarisë së tij. AU nëpërmjet kërkimit shkencor synon:

- të rrisë shkallën e kualifikimit të stafit akademik;
- nëpërmjet pjesëmarrjes në studime dhe projekte me karakter kombëtar e ndërkombëtar të krijohen burime të tjera financimi;
- t'u ofrojë studentëve aftësi dhe njohuri shkencore dhe praktike të avancuara, nëpërmjet përfshirjes në programet mësimore të metodave dhe teknikave bashkëkohore;
- të bëjë kërkimin shkencor pjesë të aktivitetit të çdo njësie përbërëse.

AU u ofron lehtësitë dhe mundësitë anëtarëve të stafit akademik për pjesëmarrje në konferenca shkencore, botim artikujsh dhe monografi. AU mbetet motivuese edhe për botime të teksteve mësimore sipas një procedure të diskutimit paraprak në strukturat përkatëse.

Një rol në zhvillimin e kërkimit shkencor në AU luan dhe Zyra e Koordinimit të Kërkimit-Shkencor dhe Botimeve Akademike. Kjo zyrë formulon dhe orienton politikat e zhvillimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore në vijimësi; bashkërendon dhe koordinon punën kërkimore të fakulteteve dhe të departamenteve, duke respektuar liritë akademike të stafit akademik dhe drejtues; promovon veprimtarinë kërkimore-shkencore të universitetit brenda e jashtë vendi; nxit pedagogë e drejtues të departamenteve dhe të fakulteteve për punë kërkimore shkencore dhe pjesëmarrjen e tyre, si individë në projekte në shkallë departamenti, fakulteti, universiteti, kombëtare dhe ndërkombëtare; ndjek zbatimin e orientimeve, të planeve, të projekteve dhe tematikës e problematikës së miratuar në departamente; raporton sistematikisht në Senatin e Universitetit dhe merr detyra prej tij [<https://albanianuniversity.edu.al/sq/zyra-e-orjentimit-dhe-koordinimit-shkencor/>].

Departamenti i Inxhinierive gjatë vitit akademik 2017-2018 ka patur një aktivitet kërkimor të larmishëm, që nga pjesëmarrje në projekte Erasmus+ e deri në pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare [Evidencë 114]. Në mënyrë të përmbledhur aktiviteti kërkimor i Departamentit të Inxhinierive pasqyrohet në tabelën 13 dhe 14 (Aneksi 1), ndërsa në mënyrë të detajuar jepet lista e botimeve, projekteve, trajnimeve etj. të stafi akademik [Evidencë 104]. Megjithatë duhet theksuar që në këtë pasqyrë rreth gjysma e aktivitetit kërkimor e botues i takon PAK të Departamentit.

Nga ana tjetër, për PAE të angazhuar në këtë program studimi, mungojnë botimet në revista të njohura ndërkombëtare si dhe referime në aktivitete shkencore ndërkombëtare (simpoziume, konferenca etj.) me impakt të lartë në fushën e teknologjisë së informacionit.

Një kontribut në drejtim të publikimit të rezultateve të kërkimit shkencor luan dhe revista shkencore OPTIME [<https://albanianuniversity.edu.al/sq/revista-optime/>] si organ shkencor i AU, konceptuar dhe realizuar si tribunë e mendimit akademik për tema e probleme të teorisë dhe të praktikës së mësimdhënies, si hapësirë e domosdoshme për publikimin e punimeve studimore shkencore, drejtuar e realizuar nga organizmat akademike.

Rekomandim: PAE duhet të bëjë më shumë për kualifikimin e tij. Të rrisë numrin e botimeve shkencore brenda dhe jashtë vendit si dhe pjesëmarrjen në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e Teknologjisë së Informacionit. Kontribut pozitiv në këtë drejtim do të kishte reduktimi i ngarkesës mësimore dhe i numrit të lëndëve të zhvilluara.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Pedagogët e AU kanë kryer kërkime të cilat i kanë prezantuar në konferencat e organizuara nga vetë institucioni ose në konferenca të organizuara nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit [Evidencë 104].</p> <p>Personeli akademik përmes angazhimit të tij në kërkimin shkencor dhe publikimeve të tij, jep kontribut në zhvillimin e shkencës dhe sektorëve të prodhimit dhe shërbimit në fushat që lidhen me to</p> <p><i>Rekomandohen botime në revista të njohura të fushës dhe referimet në aktivitete shkencore ndërkombëtare të spikatura.</i></p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Master i Shkencave në Teknologji Informacioni e zhvillon procesin mësimor në gjuhën shqipe.</p> <p>Departamenti nuk ofron programe studimi në gjuhë të huaj.</p>
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtëjshëm të personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtëjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe</p>	<p>AU ofron mbështetje për kualifikimin e mëtëjshëm të personelit akademik dhe mbështetje për aftësimin për përdorimin e metodologjisë bashkëkohore të mësimdhënies, për hartimin e programeve</p>

atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.

lëndore, për specifikat e mësimdhënies universitare, për njohjen me prirjet e zhvillimit të arsimit të lartë, për bashkëpunimin me qendrat e zhvillimit të kërkimeve, etj.

Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.

AU disponon të dhënat për studimet shkencore, tekstet, monografitë, librat, artikujt apo kumtesat në konferenca si dhe të dhëna për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në programet e studimit. Këto të dhëna azhurnohen periodikisht.

AU disponon një bazë të dhënash për botimet shkencore brenda dhe jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi.

Këto të dhëna azhurnohen periodikisht në rang Departamenti dhe i transmetohen Zyrës së Koordinimit të Kërkimit-Shkencor dhe Botimeve Akademike.

Konkluzionet e vlerësimit:

- AU ka të angazhuar një staf akademik (PAE+PAK) të kualifikuar dhe me përvojë në mësimdhënie dhe në kërkim shkencor;
- GVJ evidenton se Departamenti ka një lidhje të vazhdueshme me të gjithë stafin akademik të angazhuar në procesin mësimor. Pedagogët kanë kryer kërkime shkencore personale dhe duke angazhuar në to edhe studentët, të cilat i kanë prezantuar në konferencat e organizuara nga vetë institucioni ose në konferenca të organizuara nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit;
- Në mbështetje të kërkimit shkencor AU, nëpërmjet revistës shkencore "Optime", i mundëson stafit akademik të botojë në të artikujt shkencorë;
- Universiteti nuk angazhohet drejtpërsëdrejti në kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik të pakualifikuar, por vetëm e mbështet atë në çdo nevojë shkencore dhe akademike për ta zhvilluar më tej atë;
- Duhet të shihet mundësia e mbështetjes ekonomike nga ana e Universitetit të botimeve shkencore në revista dhe konferenca ndërkombëtare në disiplinën përkatëse për PAE;
- Ngarkesa mësimore e lartë për PAE si dhe numri i madh i lëndëve të zhvilluara për çdo pedagog ndikojnë negativisht në angazhimin në kërkimin shkencor dhe efektivitetin e punës kërkimore.
- *GVJ rekomandon, për PAE, botime në revista të njohura ndërkombëtare si dhe referime në aktivitete shkencore ndërkombëtare me impakt të lartë në fushën e teknologjisë së informacionit.*

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Nga shqyrtimi i DVV dhe vizita në institucion konstatohet se gjatë vitit akademik 2017-2018 janë bërë përmirësime të dallueshme përsa i përket bashkëpunimit kombëtar dhe atij ndërkombëtar. Në mënyra të veçantë përmirësimet konsistojnë në:

- Lidhjen e kontratave për zhvillimin e praktikave mësimore të studentave [Evidencë 106];
- Nënshkrimin e marrëveshjeve me universitete të vendit me të cilat Departamenti i Inxhinierive ka shkëmbim stafi në kuadër të mësimdhënies [Evidencë 107, Evidencë 108, Evidencë 109 etj.]
- Zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta kërkimore me universitete vendase e të huaja për tematika të caktuara shkencore;
- Zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta me pjesëmarrjen e studentëve.

Në mënyrë të detajuar komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë jepen në tabelen 15 të aneksit 1.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>AU zhvillon një bashkëpunim të gjerë me një numër institucioneve shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, etj. Kjo kontribuon jo vetëm në realizimin e suksesshëm të praktikave të ndryshme, por edhe për kontakte me tregun e punës me qëllim punësimin e studentëve të diplomuar.</p> <p><i>Megjithëse kemi të bëjmë me marrëveshje të nënshkruara, këto bashkëpunime, sidomos me biznesin privat, janë vështirësisht të qëndrueshme në kohë.</i></p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së</p>	<p>AU, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit dhe shkëmbimin e informacionit në forma të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkëmbimit të informacionit, diskutim në mbledhje departamenti. • Vlerësim të punës dhe matjes së

<p>përgjegjësi respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>performancës së secilit pedagog. Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi nëpërmjet ndarjes së detyrave të cilat përcaktohen në Rregulloret përkatëse.</p>
<p>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierive për realizimin e objektivave të programit të studimit Master i Shkencave në “Teknologji Informacioni” ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me aktorët e biznesit vendas.</p> <p>Në mënyrë të veçantë, Departamenti i Inxhinierive, ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.</p> <p><i>Institucioni nuk ka organizuar trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e tij të diplomuar, dhe ky kriter ka vend për t’u përmirësuar në të ardhmen.</i></p> <p>Nuk ka një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale.</p> <p><i>Universiteti duhet të shtrijë fushat me kompani më të mëdha të Teknologjisë së Informacionit për mbarëvajtjen e praktikës profesionale dhe punësimin në të ardhmën të studentëve.</i></p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<ul style="list-style-type: none"> - AU zhvillon një bashkëpunim të konsiderueshëm me një numër institucionesh shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, etj. - <i>Rekomandohet</i> zgjerimi i marrëveshjeve bashkëpunuese për realizimin e praktikave si dhe bashkëpunimit në fushën e kryerjes së projekteve të përbashkëta, në mënyrë që studentët të kenë mundësi të punojnë me teknologjinë e përditësuar në të ardhmen; - <i>Rekomandohet</i> zhvillimi i marrëdhënieve të qëndrueshme në kohë, sidomos me biznesin privat; - <i>Rekomandohet</i> që AU dhe në mënyrë të veçantë Departamenti i Inxhinierive të angazhohet në ofrimin e shërbimeve për të tretët. 	
<p>Standardet e kësaj fushe janë përmbushur</p>	

ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

